

Data 11/09/2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS -PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Riparimi i dëmtimeve të turbinave të AG1 dhe AG3 në HEC Fierzë dhe 5 (pesë) agregatet në HEC Vau i Dejës”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi- 45210000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 49,902,322 (Dyzet e nëntë milion e nëntëqind e dy mijë e treqind e njëzet e dy) Lekë, pa TVSH.

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është:** HEC Fierzë 799,330 (Shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë e treqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH dhe HEC Vau i Dejës 717,725 (Shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatëqind e njëzet e pesë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c, i ndryshuar, dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor KESH sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Bazuar sa më sipër, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur të fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të vërtetuar dhe garantuar se Operatorët Ekonomik Pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Në nenin 77, pika 3 e LPP citohet ndër të tjera si më poshtë: 3. "Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: 1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore ,
- Aktin e kolaudimit;

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi/Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- Akt kolaudimi objekti;

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme të deklaruara në fazën e tenderimit;

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në pesë vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë AK, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit teknik, minimalisht inxhinierët dhe tekniket e mëposhtëm:

- ✚ 1 (një) Inxhinierë Mekanik.
- ✚ 4 (katër) Axhustatore të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të.
- ✚ 2 (dy) Saldatore të çertifikuar me EN SSH ISO 9606-1 ose ekuivalent.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomën e inxhinierëve;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2026-Shtator 2026.
- ✚ Çertifikatat përkatëse të lëshuara nga institucionet e autorizuar me ligj.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Për sa i takon inxhinierit mekanik është kërkuar, pasi nisur nga natyra e punimeve është e nevojshme që gjatë zbatimit të kontratës të jetë prezent në objekt një inxhinier mekanik i cili ka për detyrë të realizojë vlerësimin e riparimeve, përcaktimin e metodologjisë së riparimit, matjet, llogaritjet dhe kontrollet e karakteristikave gjometrike të tegelave të saldimit, etj.

Për sa i takon 4 (katër) axhustatorëve, janë kërkuar pasi tek procesi i riparimit janë evidentuar dëmtime që konsistojnë në çarjen e zonës së dëmtuar me elektroda karboni ose metoda të tjera, pastrimi dhe axhustim i sipërfaqes dhe pasi të ketë mbaruar procesi i saldimit do të bëhet axhustimi i tegelit të saldimit deri sa sipërfaqja të marrë formën gjometrike të profilit të lopatës. Duke qenë se riparimet e turbinave kanë një kohë të kufizuar pasi kërkon që agregati të jetë jashtë gatishmërie është e nevojshme që të jenë minimalisht katër axhustator me qëllim avancimin e punimeve.

Për sa i takon 2 (dy) saldatorëve, janë kërkuar pasi procesi kryesor i riparimit është saldimi. Duke qenë se saldimi në këtë rast, është proces i vështirë pasi janë hapësira të kufizuara si dhe është saldimit ndërmjet dy metaleve të ndryshme çelik inoks dhe çelik i zakonshëm kërkohet që saldatorët të jenë profesionist dhe të certifikuar sipas EN SSH ISO 9606-1 ose ekuivalent. Standart ky i cili specifikon kërkesat për testimin e kualifikimit të saldatorëve për saldimin me shkrirje të çeliqueve. Sikurse është theksuar që riparimet e turbinave kanë një kohë të kufizuar pasi kërkon që agregati të jetë jashtë gatishmërie është kërkuar që minimalisht të jenë dy saldatorë që punojnë njëkohësisht.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht 1 (një) Specialist, i cili të jetë ekspert i certifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit UNI EN SSH ISO 9712 ose ekuivalent. Specialisti mund të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik ose i nënkontraktuar me anë të një marrëveshjeje.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

-  Kontratë pune të vlefshme / kontratë marrëveshjeje bashkëpunimi të vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër;
-  Çertifikatat përkatëse të lëshuara nga institucionet e autorizuar me ligj.
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Korrik 2026-Shtator 2026 rastin nëse specialist do të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik;

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Për sa i takon 1(një) specialist i cili të jetë ekspert i çertifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit UNI EN SSH ISO 9712 ose ekuivalent, është kërkuar pasi procesi i verifikimit të dëmtimeve të realizohet duke aplikuar metodat e kontrollit pa shkatërrim (NDT) të cilat mundësojnë evidentimin e dëmtimeve të cilat nuk mund të verifikohen me kontroll visual. Gjithashtu dhe procesi i saldimit verifikohet duke përdorur këto metoda për të siguruar që saldimi është realizuar pa gabime strukturore. Për këtë qëllim është e nevojshme që gjatë riparimit të jetë present një Specialist, i cili të jetë ekspert i çertifikuar për kontrollet NDT, sipas standartit UNI EN SSH ISO 9712 ose ekuivalent të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- 1) SSH EN ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- 2) SSH EN ISO 14001: “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- 3) SSH EN ISO 45001: “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshur, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

SSH EN ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, është e nevojshme për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar produktet dhe proceset e punëve.

SSH EN ISO 14001: “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”, Sistemi i Menaxhimit Mjedisor, është e nevojshme që kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

SSH EN ISO 45001: “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, Standardi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë së Punës, është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë

personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlersimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e kontrates, duhet të disponojë këto paisjet dhe makineritë e mëposhtme:

NR.	EMRI I MJETIT	NJËSI	SASI	STATUSI
1	Pajisje për prerje me elektroda karboni	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Pajisje saldimi për elektroda inoksi	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Furrë tharje për elektroda	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Pajisje axhustimi me përmasa të vogla	copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Pajisje për shpimin në zonat e lopatave të rrotës së punës	copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Kamionçinë vinç 1 - 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh, aktet e zhdoganimit ose faturë tatimore të shitblerjes orgjinale ose fotokopje e noteruar ose kontratë qiraje të noterizuar.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit. Kur janë në pronësi të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni i automjetit, çertifikata e kontrollit teknik.
- Për mjetet e siguruar me qira, dokumentat e mësipërm duhet të shoqërohen edhe me kontratën përkatëse noteriale të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, i ndryshuar, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Konkretisht janë kërkuar pajisjet dhe makineritë e mësipërme pasi:

Pajisje për prerje me elektroda karboni: Pasi konstatohet dëmtimi i turbinave, procesi i parë që realizohet është prerja/çarja e zonës së dëmtuar deri në thellësinë ku ndërpritet dëmtimi. Ky proces realizohet duke përdorur elektroda karboni dhe për këtë arsye është e nevojshme që të përdoret minimalisht një pajisje e tillë.

Pajisje saldimi për elektroda inoksi: procesi kryesor i riparimit është saldimi i zonave të dëmtuara. Për këtë arsye nevojiten të përdoren pajisje për saldim me elektroda inoksi pasi materiali bazë i lopatave të turbinës është inoks. Nevojiten minimalisht dy pajisje saldimi për dy saldatorët.

Furrë tharje për elektroda: Duke qenë se ambienti i punës në turbinë është me lagështi shumë të lartë është e nevojshme që elektrodën të trajtohen nga pikpamja e lagështisë para se të përdoren. Për këtë arsye nevojitet një furrë për tharjen e elektrodave.

Pajisje axhustimi me përmasa të vogla: Pasi realizohet prerja/carja e zonës së dëmtuar dhe pasi përfundon saldimi është e nevojshme të realizohen axhustime të vazhdueshme për pastrimin e zonës dhe konfigurimin gjeometrik të profilit të lopatës së turbinës. Për këtë arsye nevojiten katër pajisje axhustimi për katër axhustatorët. Duke qenë se hapësirat janë të kufizuara nevojiten që pajisjet të jenë me përmasa të vogla.

Pajisje për shpimin në zonat e lopatave të rrotës së punës: Me qëllim ndërprerjen e zonës së dëmtimit në turbinë përdoret procesi i shpimit në zonën kufitare të dëmtimit. Për këtë arsye është e nevojshme të përdoren pajisje për shpimin në zonat e lopatave të rrotës së punës për katër axhustatorët.

Kamionçinë vinç 1 - 1.5 ton: Do të jetë e nevojshme për transportimin e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë procesit të punës. Nevojitet me vinç për të mundësuar shkarkimin dhe ngarkimin e pajisjeve në kantier të tilla si saldatricet, etj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Grupi i punës ka ndërmarrë procesin për hartimin e specifikimeve teknike për riparimin e dëmtimeve të turbinave të Ag. 1 dhe Ag. 3 në HEC Fierzë dhe të 5 agregateve në HEC Vau i Dejës. Ky proces bazohet në kërkesat specifike të procedurës së riparimit të dëmtimeve të turbinave në të dy HEC-et, me qëllim kryesor garantimin e funksionimit normal të agregateve.

Parimi kryesor i hartimit të specifikimeve është garantimi i përputhshmërisë së plotë teknike të kërkesave të riparimit me natyrën dhe madhësinë e dëmtimeve që mund të konstatohen.

Për këtë arsye, specifikimet teknike, si metodologjia e punës, proceset përgatitore, etj., janë përcaktuar duke marrë si referencë të drejtpërdrejtë natyrën dhe madhësinë e dëmtimeve që janë konstatuar në këto turbina, si dhe eksperiencën shumëvjeçare të punës.

Njësia e prokurimit